

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË
PËR KATEGORINË E MESME DREJTUESE**

Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të VKM nr.242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

1 (një) Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - klasa: II-1.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se, pozicioni është ende vakant, është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË)
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

05.05.2024

LËVIZJE PARALELE

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

11.05.2024

NGRITJE NË DETYRË

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Përgjigjet për miradministrimin e veprimtarisë ekonomike, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, procedurave të prokurimeve dhe shërbimeve të tjera mbështetëse të institucionit, dhënien asistencë për të gjithë personat që paraqiten pranë institucionit ose në telefon për të paraqitur ankesë, si dhe arkiv-protokollin.
- Drejton dhe kontrollon shërbimet e nevojshme për stafin e institucionit.
- Ndjek mirëmbajtjen e pajisjeve, duke mbajtur kontakt me specialistët e fushave të ndryshme që kontraktohen për riparime.
- Organizon punën përplotësimin e nevojave të institucionit për lëvizje dhe mbajtjen në gatishmëri të burimeve, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve periodike.
- Ndjek procedurat e hartimit dhe zbatimit të buxhetit, të parashikuara në legjislacionin përkatës.
- Siguron planifikimin dhe realizimin e prokurimeve për të gjitha fondet e parashikuara në buxhetin, të planifikuara për mallra, shërbime dhe ndërtime të nevojshme për institucionin, në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe legjislacionit në fuqi
- Siguron përcaktimin e sistemit të zbatueshëm të sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit dhe kujdeset që sistemi të përdoret nga stafi institucionit.
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave dhe realizimin e shërbimeve të arkiv-protokollit.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës klasë II;
- b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c) Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.*
- b) Të kenë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në profesion.
- c) Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a. Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- c. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;*
- d. Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
- e. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g. Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- h. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- i. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt (për kandidatët në marrëdhënie pune 6 mujori i dytë i vitit 2023);
- j. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- k. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5, kati 3, (tek Avokatura e Shtetit), Tiranë, brenda datës **05.05.2024**.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s'kualifikim të kandidatit.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **07.05.2024**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e mos kualifikimit ([nëpërmjet adresës së e-mail](#)).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Njohuritë mbi Ligjin nr.10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Njohuritë mbi Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimin të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në

kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimit për Lëvizjen Paralele brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimimit, nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare dhe në stendën e informimit të publikut. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

2

NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se, është ende vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Këtë informacion do ta merrni në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit për publikun të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke filluar nga data 21/05/2024.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar klasa III-1 ose III-2.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.*
- b) Të kenë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në profesion.
- c) Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a. Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- c. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;*
- d. Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
- e. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g. Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- h. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- i. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt (për kandidatët në marrëdhënie pune 6 mujori i dytë i vitit 2023);
- j. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- k. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5, kati 3, (tek Avokatura e Shtetit), Tiranë, brenda datës **11.05.2024**.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s'kualifikim të kandidatit.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **21/05/2024**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e mos kualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Njohuritë mbi Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në

katëgorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimi për Ngritje në Detyrë brenda **3** ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda **5** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimimit nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare dhe në stendën e informimit të publikut. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit të publikut të institucionit, për fazat e mëtejshme:

- *për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;*
- *datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.*

*Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit për publikun të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke filluar nga data: **21/05/2024**.*